



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosova

ZYRA RREGULLTORE PËR UJËSJELLËS DHE KANALIZIM
REGULATORNI URED ZAVODU I KANALIZACIJE
WATER AND WASTEWATER REGULATORY OFFICE



210/7
DT
05.08.2014

ZRRUK/UTSH-07/08/2015

05 Gusht 2014

Në pajtim me autoritetin e dhënë me *Ligjin Nr. 03/L-086, mbi Veprimtaritë e Ofruesve të Shërbimeve të Ujësjetllës dhe Kanalizimit*, të datës 15 Qershor 2008 me të cilën është amendamentuar *Rregullorja 2004/49 ("Ligji")*.

Konform Nenit 15. të *Rregullës për Përcaktimin e Tarifave të Shërbimeve të Ujësjetllës, Kanalizimit dhe të Furnizimit të Ujit me Shumicë në Kosovë* të datës 24 Dhjetor 2012 (*Rregulla ZRRUK R-02/U&K*) dhe Politikave Tarifore të datës 18 Mas 2014.

Duke u bazuar në të dhënat e aplikacionit për Tarifa Shërbimi të dorëzuara nga NH "Ibër-Lepenc" sh. a. Prishtinë dhe në procesin e zhvilluar të analizave dhe të vlerësimit të tyre,

Zyra Rregullatore për Ujësjetllës dhe Kanalizim ("ZRRUK") lëshon këtë:

URDHËRESË PËR TARIFA SHËRBIMI

PËR PËRCAKTIM TË TARIFAVE PËR FURNIZIM TË UJIT ME SHUMICË TË PA TRAJTUAR QË DUHET TË APLIKOHEN NGA NH "IBËR-LEPENC" SH. A. PRISHTINË PËR FURNIZIM TË KRU "MITROVICA" SH. A. MITROVICË DHE KRU "PRISHTINA" SH. A. PRISHTINË,

PERIUDHA TARIFORE 2015-2017

1. Interpretimi

Në këtë Urdhëresë të Tarifave të Shërbimit (UTSH), përveç nëse konteksti e kërkon ndryshe, fjalët dhe shprehjet me shkronja të mëdha do të kenë kuptimin që u atribuohen Rregullës ZRRUK R-02/U&K.

2. Zbatueshmëria

Kjo Urdhëresë e Tarifave të Shërbimit është e zbatueshme dhe e detyrueshme për NH "IBER-LEPENC" Sh. A., me rastin e faturimit të shërbimeve të furnizimit me ujë të pa trajtuar me shumicë, për dy ujësjetllës regional, dhe atë për; KRU "Mitrovica" sh. a. Mitrovicë dhe KRU "Prishtina" sh. a. Prishtinë për njësinë e Dranasit.

ZRRUK mund t'i bëjë korrigjimet e rregullta dhe të jashtëzakonshme të tarifave të shërbimit në bazë të kërkesës së bazuar të NH "IBER-LEPENC" Sh. A.. në pajtim me nenin 15. dhe 16. të Rregullës ZRRUK R-02/U&K.

3. Pasqyra e Tarifave të Shërbimit 2015-2017

NH "IBËR-LEPENC" Sh. A. Prishtinë, për konsumatorët e vet do të aplikojë Tarifat e Shërbimit për furnizim të ujit me shumicë të pa trajtuar gjatë tri (3) viteve të periudhës tarifore 2015-2017 sikurse janë dhënë në Tabelën e më poshtme:

Tabela 1. Tarifat rregullatore për periudhën tarifore 2015-2017

Rum. rendor	KRU-të	Njësia tarifore	Tarifat bazë për vitet			Tarifat e aplikueshme për vitet		
			2015	2016	2017	2015	2016	2017
1	Mitrovica	€/m ³	0.0184	0.0184	0.0184	0.0184		
2	Prishtina	€/m ³	0.0455	0.0455	0.0455	0.0455		

4. Afati i aplikimit

Tarifat e vitit 2015 do të zgjasin një vit kalendarik dhe do të aplikohen sipas Tabelës së mësipërme të cilat janë obligues për faturim, duke filluar nga: **1 Janari 2015 gjerë me 31 Dhjetor 2015.**

Tarifat e përcaktuara në këtë UTSH janë pa TVSH.

5. Procedurat e rishikimit të tarifave

Tarifat e aplikuara për vitet 2016 dhe 2017 mund të rishikohen për përcaktim dhe aplikim gjatë viteve përkatëse në përputhje me aktet rregullative ZRRUK duke marr në konsideratë shkallen e lëvizjeve inflatore të Indeksit të Çmimeve të Konsumit në Kosovë, publikuar nga Agjencioni i Statistikave të Kosovës për periudhën e shikuar.

1. për vitin 2016, periudha inflatore e shikuar nga; dhjetor 2014 – nëntor 2015, dhe
2. për vitin 2017, periudha inflatore e shikuar nga; dhjetor 2015 – nëntor 2016.

6. Publikimi dhe Shpërndarja e Listës së Tarifave të Shërbimit

NH "IBËR-LEPENC" Sh. A. Prishtinë duhet të njoftojë Kompanitë e Ujësjellësve Regjional të cilat i furnizon me ujë të pa-trajtuar me shumicë me Tarifat e Shërbimi të përcaktuara nga ZRRUK, sipas kësaj Urdhërese Tarifore të Shërbimit, me rastin e nënshkrimit të Kontratës për Shërbime ose tu dërgojë të njëjtave kopjen e saj me faturën e radhës, pas shpalljes dhe publikimit të saj nga ZRRUK në portalin e internetit të vet; www.wwro-ks.org.


7. Apelet

NH "IBËR-LEPENC" Sh. A., ka të drejtë të apelojë këtë urdhëresë ose pjesë të saja brenda 15 ditëve të punës nga data e saj, në rast të mospajtit me këtë UTSH-ë, tek Komisioni Shqyrtues i themeluar konform nenit 34. Komisioni Shqyrtues, pika 34.1., Ligji Nr. 03/L-086 mbi Veprimtaritë e Ofruesve të Shërbimeve të Ujësjellësit dhe Kanalizimit, të datës 15 Qershor 2008

8. Gjuhët Zyrtare të Urdhëresës për Tarifa Shërbimi

Kjo Urdhëresë për Tarifa të Shërbimit publikohet në tri (3) gjuhë, dy nga të cilat janë zyrtare që përdoren në Kosovë dhe në Gjuhën Angleze.

Në rast mospërputhje në mes të versioneve të UTSH-ës, do të mbizotërojë versioni i shkruar në gjuhën Shqipe.



Raif Preteni

per Drejtor i ZRRUK